

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr./No. i Protokollit: 585/18
 Nr./No. i Protokollit: 585/18
 Data: 03/07/18
 Datum: 03/07/18
 Data: 03/07/18

Nr./No. i Protokollit: KM-MI-01
 Nr./No. i Protokollit: KM-MI-01
 Data: 02
 Datum: 02
 Data: 02

PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr./No. i Protokollit: 6330
 Nr./No. i Protokollit: 6330
 Data: 03.07.18
 Datum: 03.07.18
 Data: 03.07.18

Nr./No. i Protokollit: 01
 Nr./No. i Protokollit: 01
 Data: 02
 Datum: 02
 Data: 02

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
 Ministarstvo Infrastrukture
 Ministry of Infrastructure

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr.82, 21 tetor 2010), Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenit 132, par. 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative (gazeta zyrtare nr. 20/21 qershor 2016), nenit 6 të Udhëzimit administrativ nr. 6/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.9/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, si dhe duke u bazuar në rekomandimin e komisionit profesional nr.4200 datë 08.05.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e Shoqatës e Transportuesve Publik "Rahoveci" kundër vendimit për shpalljen e nisjeve të lira nr. 2556, dt. 21.03./2018 për relacionet: Gjakovë-Xërxë - Rahovec (Tranzit) - Malishevë (Tranzit) - Prishtinë me nisje 06:45 dhe 14:00 dhe kthim 11:45 dhe 20:15) si dhe relacionin Malishevë-Prishtinë me nisje (10:10 dhe 13:00 kthim 13:20 dhe 15:20), ndërsa vendimi nr. 2556, dt. 21.03.2018 mbetet në fuqi.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni i emëruar me vendimin e Ministrit nr. 3166 dt. 06.04.2018, pas shqyrtimit të ankesës nr. 2917 të datës 30.03.2018 të parashtruar nga Shoqata e Transportuesve Publik "Rahoveci" kundër vendimit për shpalljen e nisjeve të lira nr.2556 dt. 21.03.2018, gjegjësisht relacionit Gjakovë-Xërxë - Rahovec (Tranzit) - Malishevë (Tranzit) - Prishtinë me nisje 06:45 dhe 14:00 dhe kthim 11:45 dhe 20:15) si dhe relacionin Malishevë- Prishtinë me nisje (10:10 dhe 13:00 kthim 13:20 dhe 15:20), pas shqyrtimit të ankesës dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, respektivisht paragrafin (4) të nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, duke pas parasysh

rrjetin aktual të linjave ndërurbane si dhe shpalljen e nisjeve të lira nr.2556 dt. 21.03.2018, komisioni konstatoi dhe vlerësoi që nisjet e shpallura, respektivisht relacioni Gjakovë-Xërxë - Rahovec (Tranzit) - Malishevë (Tranzit) - Prishtinë me nisje në ora 06:45 dhe 14:00 dhe kthim 11:45 dhe 20:15 nuk pengon në nisjet aktuale të lëshuara nga MI-ja në relacionin aktual pasi që kjo është trasë e re, ndërsa relacioni tjetër i ankimuar Malishevë- Prishtinë me nisje (10:10 dhe kthim 13:20) komisioni konstatoj që nisjet e shpallura nuk pengojnë në nisjet ekzistuese sepse koha minimale e operimit ndërmjet nisjeve është 15 minuta dhe në rastin konkret nisjet e shpallura kanë kohë mbrojtëse mbi 15 minuta, respektivisht 20 minuta.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë dhe duke ju referuar legjislacionit në fuqi Ministria e Infrastrukturës ka vlerësuar të domosdoshme shtimin e numrit të nisjeve të reja në mënyrë që të kemi shërbime të mjaftueshme për udhëtarët që frekuentojnë në këtë relacion duke krijuar një treg liberal për bartjen e udhëtarëve e cila ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të transportit për udhëtarët.

Duke u mbështetur në paragrafin (4) të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus, Ministria e Infrastrukturës e ruan të drejtën e shpalljes së nisjeve të lira. Andaj në rastin konkret, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve për të pasur linja në këtë relacion për të ofruar cilësi në shërbime të transportit, komoditet si dhe arritje më të shpejt në destinacion, MI ka bërë shpalljen e nisjeve të lira.

Prandaj, në mbështetje të nenit 132, par. 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Minsitri i Infrastruktures ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet mjet i rregullt juridik. Pala e pakënaqur mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.



Iu dergohet:
Shoqatës e Transportuesve Publik "Rahoveci";
Departamentit të Transportit, MI;
Arkivit;